



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 38
Prishtinë, më 23 nëntor 2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-II-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Faton Topalli, Ali Sadriu, Hajdar Beqa, Abdyl Ymeri, Synavere Rysha, Naim Fetahu dhe Fikrim Damka.

Munguan: Enver Hoti dhe Bali Muharremaj.

Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit; Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Mentor Hyseni, GIZ.

Pjesëmarrësit tjerë në takim: Sokol Havolli, Fitim Krasniqi, Valdet Gjinovci, Isa Krasniqi nga ZKM dhe Emine Fazliu nga ZKA.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 4.11.2016 dhe 11.11.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF-të e Zyrës së Kryeministrit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015;
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF-të e Ministrisë së Punëve të Jashtme, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015;
5. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 4.11.2016 dhe 11.11.2016

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 4.11.2016 dhe 11.11.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF-të e Zyrës së Kryeministrit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

Kryetari, theksoi se KMFP ka vendosur ta shqyrtojë raportin e auditimit për Zyrën e Kryeministrit (ZKM), për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015. Opinionin i auditimit, për këtë raport, është i pamodifikuar, me theksim të çështjes. Theksimi i çështjes ka të bëjë me faktin se nga kategoria e investimeve kapitale ishin paguar 1,763,717€ për projektet e AUV-it, këto mjete ishin për furnizime me mallra dhe shërbime dhe subvencionim i fermerëve. Vlera e pasurive financiare mbi 1,000€ e shpалosur në PVF, nuk ishte e saktë, sepse nuk ishte paraqitur vlera e tokës së AUV-it, e cila ishte vlerësuar 1,822,000€, pas dorëzimit të PVF-ve. Dhe, për katër subvencione të dhëna në vlerë 31,000€, përfituesit e mjeteve nuk kishin ofruar dokumentacion, për të arsyetuar shpenzimin e mjeteve. Me këtë hapi diskutimin.

Naim Fetahu, theksoi se deri në fund të auditimit për vitin 2015, 2 rekomandime ishin implementuar plotësisht, 6 ishin në proces të implementimit, derisa 10 të tjera nuk ishin implementuar ende. Rekomandimet e paimplementuara ndërlidhen kryesisht me: menaxhimin e subvencioneve, raportimin e brendshëm dhe linjat e llogaridhënies, pagesat nga kategoria e investimeve kapitale, procesimin e pagesave përmes prokurimit, vonesat në mbyllje të avancave, etj. Si rezultat i mosimplementimit të rekomandimeve, disa nga to janë përsëritur edhe gjatë vitit 2015. Po ashtu, theksoi se opinionin i auditimit, për këtë raport, është i pamodifikuar, me theksim të çështjes. Theksimi i çështjes ka të bëjë me faktin se nga kategoria e investimeve kapitale ishin paguar 1,763,717€. Njësia e Auditimit të Brendshëm, për shkak të mungesës së stafit, nuk kishte arritur ta realizojë tërë planin vjetor të punës, pasi që janë kryer vetëm tre nga katër auditimet e planifikuara. Përveç kësaj, edhe implementimi i rekomandimeve nuk ishte në nivel të kënaqshëm, nga 28 rekomandimet e dhëna në tri raporte, vetëm 8 ishin të implementuara plotësisht. Në 84 raste, zotimi së bashku me urdhër-blerjet në vlerë totale 792,062€, si dhe në 11 raste urdhër-blerjet në vlerë totale prej 68,964€, ishin përgatitur pas pranimit të furnizimeve të mallrave dhe shërbimeve, përkatësisht pas pranimit të faturës; Mangësitë më të rëndësishme të evidentuara ne procedura të prokurimit ishin për shkak të ndryshimeve në staf ishin zhvilluar 8 procedura prokurimi për furnizim me mallra të teknologjisë në ZKM, nuk ishte kërkuar letër për shpjegim për çmimin jo-normalisht të ulët në kontratën ‘Intervistimi dhe grumbullimi i të dhënave statistikore në teren’, në një lot në kontratën ‘Furnizim me kite, reagjent dhe material shpenzues’ ishte shpërblyer ofertuesi i cili kishte ofruar çmim për 2,370€ më të lartë sesa çmimi

më i lirë. Një rast në AUV, pozita menaxhuese mbahej nga ushtruesi i detyrës, që nga maji i vitit 2015, duke kaluar afatin maksimal 6 mujorë.

Për të gjitha çështjet e ngritura më lart, ne kemi dhënë rekomandimet tona dhe ZKM ka dorëzuar në afatin e paraparë ligjor planin e veprimit për implementimin e të gjitha rekomandimeve. Po ashtu, do të ishte e dobishme që zbatimi i këtij plani të monitorohet në baza të rregullta mujore.

Ali Sadriu, theksoi se numri i madh i agjencive të pavarura, brenda ZKM-së, paraqet vështirësi në funksionimin e vetë organizatës. Po ashtu, numri i madh i rekomandimeve të pazbatuara tregon se brenda ZKM-së ka pasur telashe në organizim. Po ashtu, nga të gjeturat e auditorit, vërehet se shkeljet janë në Agjencinë e Veterinës dhe Ushqimit, si dhe në Agjencinë e Statistikave të Kosovës.

Hajdar Beqa, theksoi se numri i madh i agjencive të pavarura, që janë nën administrimin e Zyrës së Kryeministrit, po paraqet probleme në funksionimin normal të vetë ZKM-së. Të gjeturat e auditorit të jashtëm kanë të bëjnë me Agjencinë e Veterinës, po ashtu edhe Agjencinë e Statistikave. Përgjatimisht, shpenzimet nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, që janë në programe të vetë ZKM-së.

Faton Topalli, theksoi se në raportin e auditimit, ka pasur keqpërdorim të subvencioneve, regjistrime në kode ekonomike joadekuate, mosarsyetim i subvencioneve, mosmbyllje të avancave me kohë etj. Për këtë kërkoi përgjigjeje nga përfaqësuesit e ZKM-së.

Ali Sadriu, theksoi se keq-klasifikimi i buxhetit tek Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit, ka reflektuar në dhënien e opinionit jo të mirë për vetë Zyrën e Kryeministrit. Lidhur me këtë pyeti se cilat veprime janë ndërmarrë nga AVUK për adresimin e kësaj çështje? Nga kategoria e investimeve kapitale ishin paguar 1,763,717€ për projektet e AUV-it, këto mjete ishin për furnizime me mallra dhe shërbime dhe subvencionim i fermerëve. Vlera e pasurive financiare mbi 1,000€ e shpalosur në PVF nuk ishte e saktë, kjo pasi që nuk ishte paraqitur vlera e tokës së AUV-it, e cila ishte vlerësuar 1,822,000€, pas dorëzimit të PVF-ve, dhe katër subvencione të dhëna në vlerë 31,000€, përfituesit e mjeteve nuk kishin ofruar dokumentacion për të arsyetuar shpenzimin e mjeteve.

Fitim Krasniqi, paraqiti hapat e veprimit të vetë ZKM-së, në kontest të adresimit të rekomandimeve nga të gjeturat nga raporti i auditimit. Duke theksuar se ZKM-ja ka përgatitur planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve, ka përcaktuar objektivat, është hartuar udhëzuesi i nevojshëm për të detajuar hapat konkretë dhe të përcaktuar, takimet e shpeshta të Bordit të Drejtorëve, me qëllim të adresimit të rekomandimeve. Po ashtu, u përgjigj në të gjitha pyetjet e deputetëve. Më tej, theksoi se të gjeturat në shumicën e rasteve kanë të bëjnë me Agjencinë e Veterinës dhe Ushqimit, si dhe me Agjencinë e Statistikave. Numri i madh i agjencive brenda ZKM-së, paraqet probleme në funksionim normal të ZKM-së. Besoj se nga viti 2017, këto agjenci do të jenë jashtë ZKM-së.

Valdet Gjinovci, paraqiti hapat që janë marrë në kontest të adresimit të rekomandimeve. Është e vërtetë se ne jemi pajtuar me të gjeturat e auditorit të jashtëm.

Isa Krasniqi, theksoi se Agjencia për Statistikat, po ashtu, ka përgatitur planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve, si dhe theksoi se të gjeturat nga auditori i jashtëm, janë të sakta. Megjithatë, natyra e punës së vetë agjencisë, na ka shtyrë të bëjmë, ndoshta pa dashje, edhe shkelje të proceduarve.

Fikrim Damka, pyeti lidhur me subvencionet dhe transferet e ndara, në kuadër të ZKM-së, për komunitetet. Sipas të dhënave për vitin 2016, del se nga 2 milionë euro të ndara, janë shpenzuar mbi 0.6 milion euro, megjithatë kjo shumë nuk është shpenzuar për komunitete tjera, por vetëm për komunitetin serb. Pse është ky dallim? Po ashtu, theksoi se tani në projektbuxhetin e vitit 2017, do të paraqesim kërkesë që ky buxhet të jetë i ndarë për secilin komunitete veç e veç.

Naim Fetahu, theksoi se ZKM është një organizatë mjaft specifike, për shkak të numrit të madh të agjencive të pavarura. Disa rekomandime nuk janë të lidhura drejtpërsëdrejti me ZKM-në.

Faton Topalli, propozoi që të jepet rekomandim për ZKM-në lidhur me çështjet e ngritura nga raporti i auditimit.

Përfundim

KMFP, vendosi që Raportin e auditimit për PVF- të e ZKM-së, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të mos e adresojë për në seancë plenare, por ZKM të përgatisë planin e veprimit, duke caktuar personat përgjegjës dhe duke caktuar afatet kohore, për të gjitha rekomandimet e dala nga Raporti i auditimit për Zyrën e Kryeministrit, për vitin 2015. Po ashtu, me raport me shkrim, brenda 3 muajve, ta njoftojë Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, se deri ku ka arritur me zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së.

4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Punëve të Jashtme, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

Kryetari, theksoi se ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme gjendet në udhëtim jashtë vendit dhe nuk do të marrë pjesë në mbledhje të Komisionit. Andaj, në mungesë të ministrit, kjo pikë e rendit të ditës do të shqyrtohet në një mbledhje të radhës së KMFP-së.

5. Të ndryshme

Kryetari, pasi nuk pati diskutime për këtë pikë, e mbylli takimin.

Takimi përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Faton Topalli